



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
TEATRI KOMBËTAR I OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I SHËRBIMEVE

Nr. 1324 Prot
1

Tiranë, më 02/11 /2023

NJOFTIM

Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor, në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi Punës i RSH”, i ndryshuar; Ligjit Nr.10 352, datë 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën” i ndryshuar neni 9 pika 1, gërma ç; neni 13 e në vijim; VKM-së Nr. 176, datë 29.03.2006, “Për botimin e buletinit të njoftimeve publike”; Urdhër të Kryeministrit nr 140, datë 28.03.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së TKOBAP-së”; Statutit të Institucionit të TKOBAP miratuar me urdhër të Ministrit të Ministrisë së Kulturës nr 166 datë 27.04.2015 neni 15 gërma c; Rregullores së Brendshme “Për Organizimin dhe Funksonimin e Institucionit të TKOBAP-së me nr.1850 prot datë 25.07.2014; të shpallë 1 (një) vend vakant për pozicionin e punës:

❖ **Spalë Violinë e dytë -Sektori i Orkestrës pranë Drejtorisë së Operas dhe Filarmonisë**

Për ti dhënë më shumë kohë shpërndarjes së informacionit për vende të lira pune në sektorët artistikë e për rrjedhojë për ti krijuar mundësi pjesmarrjes më të madhe në numër të konkurrentëve TKOBAP nxjerrë njoftimin e saj 30 ditë përpara.

Audicioni për këtë vend vakant do të mbahet në ambjentet e Hollit Koncertor kati i II me adresë: “Sheshi Skënderbej” Tiranë, në datën **15.12.2023, ora 10:00**.

Të gjithë artistët që janë të interesuar për tju nënshtruar audicionimit, duhet të dorëzojnë pranë zyrës së protokollit të Institucionit të TKOBAP-së deri në datën **07.12.2023 ora 16:30** dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

Kriteret e përgjithshme (dokumentacioni):

1. Të ketë kryer studimet e larta mastër diploma (Violinë) brenda ose jashtë vendit;
2. Fotokopje të diplomës dhe listë notash të noterizuar në shtetin përkatës;
3. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë) ose një dokument ekuivalent me të;
4. Fotokopje e dokumentit të identitetit të vlefshëm;
5. Vërtetim të gjendjes shëndetësore, ose një dokument ekuivalent me të;
6. Vërtetim të gjendjes gjyqësore, ose një dokument ekuivalent me të;

7. Një kopje të Curriculum Vitae bashkëngjitur me Foto, (veprimtaria në vite e çertifikuar, mastër class, Work shop, programe koncertesh, recitalesh, shfaqje të ndryshme, si dhe të dhëna të tjera që plotësojnë figurën artistike, experience pune për vendin që aplikon, tituj artistik etj). Dokumentacionin e nevojshëm për të vërtetuar këtë kriter;
8. Të ketë njohuri minimalisht të 2 gjuhëve të huaja, të detyrueshme italisht dhe anglisht.

-Kandidati/ja duhet të plotësojë kushtet për konkurim si vijon:

1. Të jetë shtetas shqiptar ose i huaj;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejon të kryejë detyrën e provuar me dokumentacionin përkatës;
4. Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
5. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje e çertifikuar nga shteti i tij;
6. Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore.

Program i detyruar:

- Koncert klasik Mozart me zgjedhje nga la/re/sol maxhor (koha e parë me kadencë);
- Koncert romantik me zgjedhje Mendelssohn, Bruch, Beethoven, Cajkovksi, Wieniawski, Brahms (koha e parë me kadencë).
- Bach, një nga numrat me zgjedhje:

1. Sarabande - Gigue;
2. Adagio - Presto;
3. Chaconne

Vështiresi Orkestrale:

- Mozart simfonia 39 (violinë e parë - finale);
- Brahms simfonia 1 (violinë e parë solo - koha e dytë);
- Straus - "Don Juan" (violina e parë - fillimi);
- Bach - "Matthew passion" nr 51 aria (violina e parë);
- Mendelssohn - "Endërr e një nate vere", scherzo (violina e dytë);
- Mozart - "Cosi fan tutte" akti 2 finale (violinë e dytë);
- Beethoven simfonia 3 - scherzo (violinë e dytë);
- Verdi - "Falstaff" akti 2 (violinë e dytë);
- Verdi - "Machbeth" akti 3 ballabili (violinë e dytë);
- Verdi - "I vespri siciliani" simfonia (violinë e parë).

***Lexim "A Prima Vista" nëse komisioni e sheh të arsyeshme;**

Shënim:

-Komisioni ruan të drejtën që të dëgjojë të gjithë ose një pjesë të programit të konkursit.

Për sqarime të mëtejshme, ju lutem mos hezitoni të na kontaktoni në adresën:
sekretaria@tkob.gov.al Elton.Katroshi@tkob.gov.al

MIRATOI

DREJTORE E PËRGJITHSHME

Abigeila VOSHTINA

